



REPUBLIKA E SHQI  
AVOKATI I POPU  
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201701696/4

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2018

**Lënda :** *Rekomandohet marrja e masave, për planifikimin e caktimit të gjykimit të çështjes administrative me Nr.31110-04562-86-2017 akti, datë 12.09.2017 që i përket shtetasit A. K., nga qyteti i Elbasanit.*

**Drejtuar : Z. KASTRIOT SELITA**  
**Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit**

**TIRANË**

*I nderuar zoti Kryetar,*

Në ankesën e tij datë 19.12.2017, drejtuar Avokatit të Popullit, Zj.Erinda BALLANCA, shtetasi A. K. nga qyteti i Elbasanit, ankohet ndaj Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në lidhje me shkeljen e të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publikë, brenda një afati të arsyeshëm në lidhje me mos planifikimin dhe mos caktimin e gjykimit të çështjes së tij me Nr. 31110-04562-86-2017 akti, datë 12.09.2017.

Ankuesi A. K. nga ana e tij, na shkruan se Gjykata Administrative e shkallës së parë Durrës, ka vendosur pranimin e kërkesë-padisë dhe kundra këtij vendimi gjyqësor është ankuar pala e Paditur, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme të Shtetit, dhe kjo çështje aktualisht ndodhet akoma në shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e rregjistruar me dt.12.09.2017, pa u planifikuar dhe pa u caktuar akoma gjykimi i saj.

Duke u bazuar në kërkesat e nenit 42/2 të Kushtetutës RSH dhe në kërkesat e nenit 48 të Ligjit me Nr.49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", mbi të drejtën e një gjykimit të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Po kështu nga neni 48 i këtij ligji ku përcaktohet se Gjykata Administrative e Apelit, shqyrton çështjen brenda 30 ditëve, nga data e ardhjes së ankimit nga Gjykata ku është paraqitur ankimi.

Ligji synon thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, dhe se qëllimi i krijimit të gjykatave administrative ishte garantimi i mbrojtjes efektive të të drejtave të subjekteve dhe interesave të tyre të ligjshme të personave, nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor, brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme.

Në këto kushte dhe duke u bazuar në kërkesat e nenit 63/3,4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se:

*”Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, nga administrata publike”, dhe kërkesat e nenit 21/b të Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, ku përcaktohet se:*

*” Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrjen e masave për vënien në vend të së drejtës së shkelur, tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”, Ju*

### **REKOMANDOJMË :**

1.Marrjen e masave për planifikimin dhe caktimin e gjykimit të çështjes gjyqësore, që i përket shtetasit A. K. nga qyteti i Elbasanit sa më shpejtë, në të ardhmen.

2.Mbi masat e marra nga ana juaj, dhe në zbatim të kërkesave të këtij rekomandimi, lutemi të njoftohemi nga ana juaj me shkrim brenda afatit 30 ditor.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimi tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Arben SHKËMBI**